



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/157  
Datë: 30.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8, dhe nenit 16, paragrafi 6, nën paragrafi 6.2 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 30 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 15, paragrafit 1. të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-213 dhe Ligjin me Nr. 08/L-235, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 gusht 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 6,323,380 € (gjashtë milionë e treqind e njëzetë e tre mijë e treqind e tetëdhjetë euro) deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht për vitin 2023, për sigurimin e teksteve shkollore.
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me kod 208, nga nën programet dhe kategoritë e shpenzimeve, si në vijim:
  - 2.1. Zyra e Ministrit me kod 11408, merret shuma prej 34,473 € (tridhjetekatërmijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre euro) nga kategorinë "mallra dhe shërbime" shuma e ndikuar negativisht është -24.99%;
  - 2.2. Trajnimi i Mësuesve me kod 91000, merret shuma prej 97,398 € (nëntëdhjete e shtatëdhjetë e tre euro) nga kategoria "mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%;
  - 2.3. Arsimi Profesional me kod 92500, merret shuma prej 102,494 € (njëqind e katërqind e tetëdhjetë e katër euro) nga kategoria e shpenzimeve "mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%;
  - 2.4. Inspektorati i Arsimit të Kosovës me kod 98000, merret shuma prej 85,116 € (tetëdhjetë e pesëdhjetë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë euro) nga kategoria "mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%;
  - 2.5. Marrëveshja Bilaterale me kod 91700, merret shuma prej 224,910 € (dyqind e njëzet e katër mijë e nëntëqind e dhjetë euro) nga kategoria "mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%;
  - 2.6. Investimet kapitale në Arsimin para-universitar me kod 98100, merret shuma prej 1,178,750 € (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e tetëdhjetë e pesëdhjetë euro) nga kategoria "mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%;

- 2.7. Administrata Qendrore me kod 11308, merret shuma prej 1,151,129 € (një milion e njëqind e pesëdhjetenjë mijë e njëqind e njëzetënëntë euro) nga kategoria e shpenzimeve "subvencione dhe transfere", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%;
- 2.8. Marrëveshja Bilaterale me kod 91700, merret shuma prej 299.880 € (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë euro) nga kategoria e shpenzimeve "subvencione dhe transfere", shuma e ndikuar negativisht është -24.99%;
- 2.9. Arsimi Profesional me kod 92500, merret shuma prej 49,230 € (dyzetënëntëmijë e dyqindetridhjetë euro) nga kategoria e shpenzimeve "subvencione dhe transfere", shuma e ndikuar negativisht është -24.98%;
- 2.10. Investimet kapitale në Arsimin para-universitar me kod 98100, merren shuma prej 3,100,000 € (tre milionë e njëqind mijë euro) nga kategoria e shpenzimeve "shpenzime kapitale", shuma e ndikuar negativisht është -11.15%, mjetet merren nga këto projekte:
  - Funkcionalizimi i laboratorëve dhe furnizimi me pako laboratorike i shkollave në arsimin para-universitar me kod 18556, shuma prej 100,000 € (njëqindmijë euro); dhe
  - Digjitalizim, pajisje me kompjuter, tabela smart e projektor me kod 19128, shuma prej 3,000,000 € (tre milionë euro).
3. Mjetet buxhetore sipas pikës 2. të këtij Vendimi, transferohen në nën-programin Investimet kapitale në Arsimin para-universitar me kod 98100, në kategorinë e shpenzimeve "subvencione dhe transfere".
4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR   
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/157  
Datë: 30.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8, dhe nenit 16, paragrafi 6, nën paragrafi 6.2 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-213 dhe Ligjin Nr.08/L-235, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, dhe Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 gusht 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 6,617,340 € (gjashtë milionë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e dyzetë euro) në zbatim të Masës 4.2 – Mbështetja për Arsimin të Pakos së Ringjalljes Ekonomike për sigurimin e materialeve mësimore.
2. Mjete sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nën programi “Programi i Ringjalljes Ekonomike” me kod 29300, kategoria e shpenzimeve “subvencione dhe transfere”, dhe ndahen në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në nën-programin “Investimet kapitale në Arsimin para-universitar” me kod 98100, në kategorinë e shpenzimeve “subvencione dhe transfere”.
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës.
4. Obligohet Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të nxjerr Vendim për caktimin e procedurave dhe kriterëve për zbatimin e Masës 4.2 – Mbështetja për Arsimin sipas pikës 1. të këtij Vendimi.
5. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR   
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë